



Drejtorati për Inspekcione

10 Nr. ____ /2022

Dt. 16 / 01 /2023

Për: Bashkim Ramosaj-Kryetar i Komunës

Nga: Halil Tolaj – Drejtor i Drejtoratit për inspekcione

Lënda: Raport i punës së Drejtoratit për Inspekcione për vitin 2022.

Drejtorati për Inspekcione i Komunës së Deçanit gjegjësisht inspektorët e këtij Drejtorati, gjate vitit kalendarik 2022 kanë kryer punët dhe detyrat e punës mbështetur në Ligjet dhe aktet nënligjorë si dhe rregulloreve komunale me të cilat rregullohet puna e inspektorëve sipas fushave përkatëse, duke ju përmbajtur Planit të punës së Drejtoratit për vitin 2022.

Në Kuadër të Drejtoratit gjatë këtij gjashtëmujori kanë qenë të sistemuar Inspektori i Tregut, Inspektori i Mbrojtjes së Ambientit, Inspektori i Ndërtimit (me Kontratë mbi shërbimet e Veçanta), Inspektori i Veterinës (i angazhuar me kontratë mbi shërbimet e veçanta) dhe Inspektori i Bujqësisë që njëkohësisht është edhe shef i inspektorëve.

Që nga viti i kaluar inspektori Sanitar ka kaluar në Agjensionin e Veterinës dhe Ushqimit dhe prej atëherë nuk ka Inspektor Sanitar në nivelin Komunal.

Secili nga Inspektorët ka vepruar sipas detyrës zyrtare, sipas kërkesave dhe ankesave të palëve dhe sipas kërkesave të organeve tjera kompetente.

Në mënyrë permanente është bërë mbikëqyrja inspektuese e subjekteve tregtare dhe hoteliere me theks të veçantë lidhur me respektimin e orarit të punës, vendosjen e çmimeve të mallrave për tregtim, afati i skadimit të produkteve ushqimore, ndërtimet pa leje apo në kundërshtim me lejen ndërtimore të lëshuar nga Drejtorati për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit. Në mënyrë permanente është bërë kontrolli i therjes së kafshëve në thertoret e licencuara.

Sipas kërkesave të operatorëve ekonomik është bërë pranimi i lokaleve të subjekteve sa i përket kushteve minimale higjienike teknike dhe te mbrojtjes në punë.

Janë bërë kontrole sipas kërkesës së Policisë së Kosovës (me të cilët ekziston një bashkëpunim mjaft i mirë), posaçërisht për mallrat e hasura ne transportin rrugor pa dokumente përkatëse përcjellëse, mosrespektimin e orarit të punës sidomos nga subjektet hoteliere, por edhe sipas denoncimit të palëve në polici për pa

regulsihte e masura te subjektet tregtare sidomos nga lëmi i çmimeve dhe afati i skadimit të artikujve ushqimor.

Janë kryer edhe punë tjera sipas fushe veprimtarisë të secilit nga inspektorët. Në tabelën në vijim po e prezantojmë aktivitetin e inspektorëve:

Inspektori	Kontroll inspektuese në teren sipas detyrës zyrtare	Kontroll inspektuese në teren sipas kërkesës se personave fizik dhe juridik	Procesverbale të hartuara për konstatimin e gjendjes	Aktvendime	Kërkesa për gjykatat kompetente
I Tregut	50	37	87	14	4
I Ndërtimit	42	10	42	9	3
I Mbrojtjes se Ambientit	5	3	48		3 gjoba mandatorë, 3 kallxime penale.
I Veterinës	48	3	8	/	1
I bujqësisë		42	29	2	/
Gjithsejt:	145	95	214	25	8

Kërkesë: Meqense nga Inspektori i ndërtimit ka aktevdime për rrënim të objekteve të ndërtuara pa leje apo në kundërshtim me lejen ndërtimore të lëshuar nga Drejtorati për Urbanizëm, për ekzekutimin e tyre është e domosdoshme që të iniciohet procedura e prokurimit për kontraktimin e një operatori ekonomik për rrënim të objekteve pa leje ndertimore apo në kundërshtim me lejen ndërtimore.

